



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2019:082439

Datë: 17.04.2024

Numri i dokumentit: 05581541

P.nr.222/2018

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË - Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Xhemajl JUSUFI, me praktikantën e rregullt Leonita Sadiku, në lëndën penale kundër të pandehurit: A.R., për shkak të veprës penale: Kanosja nga neni 185 paragrafi 3 lidhur me paragrafin 1 të Kodit Nr. 04/L-082 Penal të Republikës së Kosovës (tutje si: KPRK), sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë PP.II.nr.884/16 e datës 26.07.2018, duke vendosur sipas detyrës zyrtare e në mbështetje të nenit 357 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të KPP-së, me datë 17.04.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. HEDHET Aktakuza e Prokurorisë Themelore Mitrovicë, me numër PP.II.nr.884/16 e datës 26.07.2018 dhe PUSHOHET procedura penale kundër të pandehurit:

A.R., nga i ati J., e ëma K., e gjinisë M., i lindur me datë ... në Mitrovicë, me numër personal të identifikimit, me adresë të vendbanimit Rr. "V.O.", Komuna Mitrovicë, Veri, i papunë, i gjendjes së mesme ekonomike serb, shtetas i Republikës së Kosovës, për veprën penale: Kanosja nga neni 185 paragrafi 3 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, për shkak të parashkrimit absolut të ndjekjes penale që ka arritur me datë 10.04.2024.

- II. Shpenzimet e procedurës penale mbesin barrë e mjeteve buxhetore të kësaj Gjykate.
- III. Sa i përket kërkesës pasurore juridike, Gjykata nuk ka vendosur.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Mitrovicë, ka ngritur Aktakuzën PP.II.nr.884/16 me datë 26.07.2018 kundër të pandehurit A.R., për shkak të veprës penale Kanosja nga neni 185 paragrafi 3 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së.

Gjyqtari e ka pranuar këtë lëndë më datë 09.01.2023 dhe pas ndërmarrjes së veprimeve dhe analizimit të shkresave të lëndës, konstaton se në këtë çështje ka arritur parashkrimi absolut i ndjekjes penale.

Sipas aktakuzës, i pandehuri është akuzuar se ka kryer veprën penale Kanosje nga neni 185 paragrafi 3 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, për të cilën vepër është paraparë dënimi me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vite. Neni 185 paragrafi 3. *Kur vepra penale nga paragrafi 1. ose 2. i këtij neni kryhet ndaj personit zyrtar në lidhje me punën apo me pozitën e tij ose ndaj disa personave ose kur vepra kryhet nga kryesi i cili vepron si anëtar i grupit, kryesi dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.*

Neni 106 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të KPRK-së, përcakton se ndjekja penale nuk mund të ndërmerret nëse kanë kaluar pesë (5) vjet nga kryerja e veprës penale të dënueshme me më shumë se tri (3) vite burgim. Ndërkaq, sipas nenit neni 107 paragrafi 1 të KPRK-së, përcaktohet se afati i parashkrimit të ndjekjes penale fillon të rrjedh nga dita kur është kryer vepra penale, ndërsa sipas paragrafit 8 përcaktohet se ndjekja penale ndalohet në çdo rast kur të ketë kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit.

Gjykata, nga gjitha faktet dhe provat e lart cekura konstaton se nga data 10.04.2013, kur dyshohet se i pandehuri A.R. se ka kryer veprën penale Kanosja nga neni 185 paragrafi 3 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, për këtë vepër penale kanë kaluar me tepër se dhjetë (10) vite, që nënkupton se duke u bazuar në dispozitën e nenit 107 paragrafi 8 të KPRK-së, në këtë rast penal ka arritur parashkrimi absolut i ndjekjes penale. Parashkrimi absolut në këtë rast penal ka arritur më 10.04.2024, ngase ka kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit të përcaktuar me dispozitën e nenit 106 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të KPRK-së.

Gjykata konstaton se parashkrimi i ndjekjes penale është një fakt dhe rrethanë që në çdo rast sapo të vërtetohet se ekziston, Gjykata obligohet sipas ligjit ta hedh aktakuzën dhe pushoj procedurën penale. Ashtu që kjo Gjykatë, pasi ka vërtetuar se ndaj të pandehurit, ka arritur parashkrimi absolut i ndjekjes penale për këtë vepër për të cilën është akuzuar, si në dispozitiv të këtij aktvendimi, ka marr aktvendim me të cilin e ka hedhur aktakuzën si dhe ka pushuar procedurën penale ndaj tij.

Aktvendimi mbi parashkrimin absolut është bazuar në kuptim të nenit 106 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 dhe nenit 107 paragrafi 8 të KPPK-së, si dhe neni 357 të KPP-së, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

Për sa i përket shpenzimeve të procedurës penale, Gjykata ka vendosur për këto shpenzime në bazë të nenit 453 paragrafi 1 të KPP-së, ku është paraparë se kur pushohet procedura penale shpenzimet e procedurës paguhen nga mjetet buxhetore, për këtë arsye edhe ka vendosur si në pikën II të dispozitivit të këtij Aktvendimi.

Për sa i përket kërkesës pasurore juridike, Gjykata nuk ka vendosur, kjo për shkak se pala e dëmtuar, S.B., ka ndërruar jetë dhe kjo vërtetohet përmes Certifikatës së vdekjes me numër V, të lëshuar nga Komuna e Mitrovicës së Veriut me datë 24.01.2024, sipas kërkesës së kësaj Gjykate.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, sipas nenit 106 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 dhe nenit 107 paragrafi 1 dhe 8 të KPRK-së, e në mbështetje të nenit 357 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të KPP-së.

GJYKATA E THEMELORE NË MITROVICË
Departamenti i Përgjithshëm
P.nr.222/18, datë 17.04.2024

Gjyqtari
Xhemajl JUSUFI

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij Aktvendimi, palët kanë të drejt ankese në afat prej 3 ditësh, nga momenti i pranimit të Aktvendimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.